

**The Old Lexicon and its Stylistic Functions Expressed by Fan Noli in the Work of Macbeth. A Comparative Study between the Original Text of Shakespeare and the Translated one by Fan Noli**



**Linguistics & Literature**

**Keywords:** Text, emotion, stylistic, lexicon, old words, speech.

**Ornela Çoku**

**Phd.Cand Ornela Çoku. Faculty of Humanities  
University "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, Albania.**

**Abstract**

The article will treat old words as lexical units. It will show the spheres of usage and their stylistic functions. The work will present that, Noli as a great stylist, has enriched the lexicon with old words which reflect the culture and folklore of the Albanian language. The article will also emphasise that Noli is a skilled-translator in selecting and in using old words, exhibiting a beautiful creation. Noli creates the idea that not only does the beauty of a narration have much to do with the existing used language and lexicon but it has also to do with the use of old words in order to conceive better the events and situations. It will show that the old lexical elements are systematically used by the skilled-translator-poet. The old lexicon makes the style of Fan Noli more vivid and more convincing. Without them the speech would be spiritless, colourless, lifeless and not interesting. The study shows that old words may have a semantic equivalence that belong to a special lexical and grammatical class that makes Fan Noli's language very attractive. The method used is juxtaposing and comparing.

**Leksiku i vjetëruar dhe funksionet e tij stilistike të shprehura nga Fan Noli në veprën e Makbeth-it. Një studim krahasues midis tekstit original të Shekspir-it dhe tekstit të përkthyer nga Fan Noli.**

Në këtë artikull do të trajtohen fjalë të cilat kanë të bëjnë me një shtresë të caktuar të leksikut. Do të trajtohen sferat e përdorimit dhe funksionet e tyre stilistike të shprehura nga Fan Noli në përkthimin e veprës së Makbethit.

**Fjalë të vjetëruara të leksikut.  
Çfarë është leksiku?**

Leksiku i një gjuhe nuk është vetëm një paraqitje e fjalëve që përmban një fjalor, por është "tërësia e fjalëve që ka një gjuhë, një dialekt, ose një e folme, fjalori: tërësia e fjalëve që përdoren në një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore ose nga një rreth shoqëror i caktuar; tërësia e fjalëve që përdor një autor në veprën e tij, fjalori i një vepre."<sup>84</sup>

Gjatë gjithë historisë së një vendi, marrëdhëniet e popullit të tij me popujt e tjerë kanë sjellë edhe ndikime në gjuhë. Kjo duket më drejtpërdrejt në sistemin leksikor. Në se do të studjojmë shtresimin e leksikut të një vendi sipas burimit do të vemë re se historia e gjuhës dhe etimologjia e saj përbëhet nga elementet e huazuara dhe nga elementet autoktone, vetjake ose mund t'i quajmë shtresa vetjake dhe shtresa e huazuara. Gjuha shqipe është gjuhë indoeuropiane. Si e tillë nuk duhet kuptuar që gjithë pasuria e saj leksikore është trashëgimi e fondit të vjetër indoeuropian.

Ne do të përqëndrohemi te leksiku i gjuhës shqipe, të përdorur nga **Fan Noli** dhe me konkretisht tek leksiku i përdorur në përkthimin e tragjedisë së Makbethit. Leksiku i përdorur në këtë vepër karakterizohet nga dy lloje fjalësh të vjetëruara: historizma dhe arkaizma të *cilat përbëjnë bazën e leksikut të shqipes*.

<sup>84</sup> Fjalor I shqipes Se Sotme. Tirane 2002. f.662

## Çfarë janë historizmat?

Historizmat janë fjalë a shprehje që kanë dalë nga përdorimi i gjallë, sepse sendi a dukuria që ato shënojnë i takojnë një periudhe historike të kaluar<sup>85</sup>. Meqë ato shënojnë sende apo dukuri të cilat nuk përdoren më në jetën tonë të përditshme konkludojmë se nocionet që shprehen prej tyre nuk janë më reale.

*Historizmat*, janë fjalë të vjetruara, që paraqesin një objekt, një send apo një koncept. Ato gjithashtu lidhen me periudha të ndryshme historike dhe sot përdoren vetëm për të paraqitur atë periudhë në mënyrë më të vërtetë. “**Fjala** është njësi leksikore e mëvetësishme, që ekziston e vetmuar e jashtë lidhjeve....Fjala është njësi leksikore që ka kuptimin e vet leksikor e gramatikor të mbyllur në vetvete, ndërsa përbërësi sintaksor është fjala emërtuese, a grupi i fjalëve emërtuese ..”<sup>86</sup> Të tilla janë fjalët ‘*than*’, ‘*rreshtar*’, ‘*komandar*’, ‘*kam*’,(arme) etj. Konceptet dhe objektet që paraqesin *historizmat* nuk janë më sot. Ato lidhen me një periudhë të kaluar historike dhe kanë dalë nga përdorimi bashkë me të.

Po ashtu themi se fjalët e vjetruara nuk bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës formale, por në letërsi përdoren me vlera stilistike të veçanta. Kështu, historizmat e shqipes të përdorura nga shkrimtari përkthyes **Fan Noli** i japin ngjyrim historik periudhës që përshkruan në veprat dhe përkthimet e tij. Kjo spikat në të gjitha veprat e **Nolit** në përgjithësi dhe në përkthimin e tragjedisë së Makbethit në veçanti.

Efekti i historizmave është shumë i madh dhe teper historik. Ekuivalentet të tyre mungojnë në gjuhën e sotme. Por duke i krahasuar ato me një perifrazim që paraqet të njëjtin objekt apo nocion të vjetruar, tregohet forca e tyre evokuese.

Në se do të studjomë etimologjinë e historizmave ato nuk kanë të njejtat vlera kuptimore në fjalët e gjuhës së sotme. Ato paraqesin në mënyrë të drejtpërdrejtë e të përpiktë sendet nocionet e epokave të shkuara. “Përdorimi i këtyre fjalëve të vjetëruara është i nevojshëm në gjuhën e shkencës, në veprat historike ku ato, të shumtën e rasteve, kanë vlerë terminologjike e nuk luajnë asnjë rol stilistik. Në veprat letrare –artistike përdorimi i fjalëve të vjetëruara ka vlerë stilistike. Historizmat përdoren në krijimet letrare si dhe në përkthimet me tematikë të ndryshme. Ato i japin tekstit kolorit historik, duke rikrijuar tipare të veçanta të jetës së dikurshme.”<sup>87</sup>

Roli dhe sasia e fjalëve të vjetruara në një vepër letraro-artistike varet nga periudha në të cilën zhvillohen ngjarjet. Ajo ka të bëjë gjithashtu nga prirjet letrare dhe nga individualiteti i shkrimtarit për të paraqitur materialin letrar. Noli është shumë i aftë në përdorimin e historizmave. Fjalët e vjetruara tek ky shkrimtar- përkthyes paraqesin kryesisht, pejsazhe dhe imazhe historike të së kaluarës. Noli në ligjërimin e tij përmban në vetvete elemente leksikore të vjetruara që karakterizojnë veprime dhe nocione të ndryshme.

Leksiku i një gjuhe gjithmonë pasurohet. Disa fjalë të vjetruara edhe mund të rihyjnë në shtresën aktive të leksikut të përdorur sot. “Në leksikun e sotëm përdoren fjalë shumë të vjetra, si edhe krijime të ditëve tona, që janë në përdorim të përditshëm, nga gjithë shoqëria ose nga grupe të caktuara njerëzish. Themi fjalë “të vjetra” dhe jo “të vjetruara”. Gjithashtu themi fjalë “të reja” që janë në përdorim të përditshëm nga gjithë shoqëria ose nga grupe të caktuara njerëzish, d.m.th. fjalë që përdoren, sepse i kërkon nevoja e marrëveshjes gjuhësore ndërmjet njerëzve”<sup>88</sup>. Për leksikun e sotëm nuk ka kufizime, nëse fjalët janë të përgjithshme ose të kufizuara nga ana territoriale a profesionale, mjaft që ato të jenë të përdorshme në ditët tona.

<sup>85</sup> Fjalor I shqipes Se Sotme. Tirane 2002. f.484

<sup>86</sup> Mehmet Çeliku, Sintaksë e Gjuhës Shqipe, ( perberesit Sintaksore), Tirane, ILAR 201219-20

<sup>87</sup> Emine Sadiku, Vezhgime mbi leksikun shprehes ne prozen e Ismail Kadarese, Tirane 1998, f. 76

<sup>88</sup> Internet Kumtesë e lexuar nga Shefkije Islamaj në Seminarin XXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare.

Në shtresën e vjetruar të leksikut bëjnë pjesë fjalët të cilat për arsye të ndryshme historike a gjuhësore sot nuk përdoren më në leksikun e përditshëm gjuhësor.

Në se do të studjojmë vlerën stilistike të fjalëve dhe të shprehjeve të vjetëruara ato rrjedhin nga natyra e tyre e veçantë, dhe vështrohen si të huaja për gjuhën e sotme.

Këto normalisht nuk i referohen objekteve apo proceseve të reja teknike. Dhe si të tilla nuk janë domosdoshmërisht teknike. Por gjithmonë fjala duhet parë në kontekst. Në paraqitjen e këtyre fjalëve do të shihen vlerat dhe funksionet e tyre stilistike.

Kështu Paul Newmark në veprën e tij 'A textbook of translation' thekson se duhet të bazohemi në funksionet stilistike të leksikut shprehës dhe konkretisht:

Në se marrim termin "urban renewal" përtëritja urbane limitohet me shtëpitë, dhe si e tillë mund të përkthehet rehabilitimin e tyre ose më e sakta do të ishte rinovimi i tyre. Po ashtu fjala në frëngjisht 'mouvance' lëvizje në anglisht mund të ketë kuptimin e 'sferë influence', sofistikim, një ekspert teknologjije, një specialist; langue de bois-

Gjuhë e rëndë burokratike; passeur nga frëngjishtja në shqip do të thotë punëtor, në gjuhën angleze trafikant i emigrantëve ilegalë.<sup>89</sup>

Duke analizuar në këtë mënyrë leksikun e përdorur nga Noli të krijohet ideja sikur Noli vepron vetëm me leksikun e vjetër. Kjo vihet re sidomos në përkthimet e veprave klasike të Shekspir, veçanërisht në tragjedinë e Makbethit, e cila është kryesisht me temë nga historia e largët.

Sasia e fjalëve të vjetëruara është e ndryshme në tekste të ndryshme të Nolit. P.sh. Tek Makbethi ka me shumicë fjalë të vjetëruara. Përkthyesi përqëndrohet qëllimisht tek këta elemente për të theksuar se kjo ishte një botë e huaj, e cila përshkruan një periudhë të largët kohore.

Një vështrim i afërt i grupeve të fjalëve të vjetëruara të përdorura në tragjedinë e Makbethit.

Leksiku i vjetëruar i përdorur nga Noli në këtë veprë ka shërbyer për të karakterizuar epokën, ngjarjet dhe personazhet. Këto fjalë dhe nocione janë shprehur me historizma. Përdorimi dhe shpërndarja e historizmave është e ndryshme. Në përgjithësi veprat dhe përkthimet e Nolit janë me temë nga e shkuara e largët ku gjenden me shumicë historizma. Fan Noli e përdor me shumë ndjenjë shtresën e vjetëruar të leksikut. Ai shpesh herë përdor elemente të vjetëruara leksikore, për të karakterizuar dhe për të bërë një paraqitje sa me dinjitoze dhe të vërtetë. Pikërisht këta elemente leksikore të vjetëruara të përdorura në mënyrë të vazhdueshme nga Noli i japin ligjërimin një atmosferë dhe një nuance të vjetër historike.

Tek Makbethi ku paraqiten skena, si dhe imagjinata lufte që ndodhin rreth shek.XV, përdoren me shumicë emërtime të objekteve dhe nocione ndryshme të asaj kohë, por që sot janë vjetëruar bashkë me emërtimet e tyre. Mbeten vetem si historizma. Është pikërisht përdorimi i tyre që e bën ligjërimin më të gjallë, dhe më të vërtetë. Pa to ligjrimi do të ishte i zbehtë, pa jetë dhe jo interesant. Ato i përkasin fushave të ndryshme Psh:

Fjale që u përkasin institucioneve të vjetëruara ose emërtime të vjetëruara institucionesh,

<sup>89</sup> Peter Newmark, A textbook of translation ,Prentice Hall Europe 1988 f.140-150

You greet with present grace and great prediction Of noble having and of **royal**  
hope, = Këtu e salutoni, me hir të shpejtm' e profeti të madhe, për zyrë më të  
lart'e shpresë froni:<sup>90</sup>

froni në këtë rast i përket marrjes së kurorës, e të bërit mbret.

Thy praises in his **kingdom's** great defence,=Ia ke mbrojtur fronin<sup>91</sup> mbretëror.

Këtu është përdorur me sensin mbretërinë e tij.

Might yet **enkindle you unto the crown**,= Të kanë për të **ndezur** për **kuroren**<sup>92</sup>

Ideja e shprehur këtu është: Do të nxisin të bëhesh mbret.

Emëra njerëzish sipas punës që kryejnë, sipas detyrës, titullit, postit, sipas fesë ose në përgjithësi :

Macbeth doth come. =Na vjen Makbethi, Kumandari<sup>93</sup>

Kuptimi i fjalës është komandanti

The king. = im atë<sup>94</sup>

Në këtë fjali im atë i referohet mbretit; Këtu mendojmë se kemi influencën fetare si ati I shenjtë . Pra Mbreti konsiderohet njeri i shenjtë.

Dismay'd not this **our captains**, Macbeth and Banquo? =Kjo gjë s'i trembi  
kapitanët<sup>95</sup> tanë.

Sot kemi fjalën kapitenet kemi evolucionin e zanores 'a ne e' mendojmë se është për lehtësi shqiptimi.

That look not like the **inhabitants** o' the earth,=

Që nuk duken ndenjësë të dheut<sup>96</sup>

Fjala ndenjësë nuk përdoret më. Në vend të saj kemi fjalën banorë.

Your servants ever Have theirs, themselves and what is theirs, in compt,=

Si veten, gjindjen<sup>97</sup>, mallin dhe shtëpinë. I kemi amanet.

---

<sup>91</sup> Po aty f.24

<sup>92</sup> Po aty f. 25

<sup>93</sup> Po aty f.19

<sup>94</sup> Fan Noli, Makbethi I Shekspir, Tiranë, Shtëpia Botuese N. Frashëri, 1943, f

<sup>95</sup> Po aty f.15

<sup>96</sup> Po aty f.20

<sup>97</sup> Po aty f.37

Në këtë fjali Noli ka përdorur gjindjen me sensin njerëzit. Kjo fjalë nuk përdoret më.

under him, My Genius is rebuked; as, it is said, = Gjenia<sup>98</sup> ime kundrejt tij përulet, Kuptimi i mirëfilltë i fjalës do me thënë shpirti im. Me këtë shprehje Makbethi don të shprehë se ai i përulet shpirtërisht Mbretit.

As sparrows eagles, or the hare the lion = Siç tremb **spurdhjak**<sup>99</sup> shkabën, lepuri luanin

sot spurdhjak nuk është shumë e përdorëshme. Fjala spurdhjak sot mund të përdoret në disa zona, me sensin negativ, mistrec. Në zonën Shqipërisë së mesme nuk është e përdorëshme.

Good **sir**, =vlla<sup>100</sup>

që do të thotë vëlla. Kjo fjalë është ende shumë e përdorshme sot, por me evulimin e gjuhës kemi të shtuar zanoren 'ë', e cila është vendosur midis dy bashkëtingëlloreve për lehtësi shqiptimi, për efekt fonetik.

Something **wicked** this way comes. =**mëkatari**<sup>101</sup> na kërkon.

Me **mëkatari** personifikohet Makbethi i cili ka kryer shumë mëkate.

you **murdering** ministers =gjakës<sup>102</sup> që vrisni,

sot kjo fjalë nuk është shumë e përdorshme. Ajo përdoret në zonat e veriut, në kanunin për të shprehur hakmarrje.

The **baby of a girl**. Hence, horrible shadow =Quame doç kurve<sup>103</sup>,

Është shprehur me tog fjalësh. Emocioni i kësaj fjale është i fortë dhe mbart sens negativ, poshtërues.

Sewer= Parengjeronjës<sup>104</sup>

Drejtuesit e shërbëtorëve. Ne mendojmë se vjen nga fjalët pararojë. Në këtë rast kuptimi leksikor është kryeshërbëtor.

Then the **liars** and swearers are fools, rremebetonjesit= rremëbetonjësit,<sup>105</sup> Kuptimi është gënjeshtarët. Në disa zona ende përdoret fjala rrenacak. Këtu shprehet ideja se cilësia e këtyre njerëzve është që të jenë vazhdimisht.

Are counsellors to fear. What soldiers, whey-face?= mblidh veten mor **katran**<sup>106</sup>

<sup>98</sup> Po aty f.71

<sup>99</sup> Po aty f.15

<sup>100</sup> Po aty f.20

<sup>101</sup> Po aty f.100

<sup>102</sup> Po aty f.33

<sup>103</sup> Po aty f.90

<sup>104</sup> Po aty f.37

<sup>105</sup> Po aty f.113

<sup>106</sup> Po aty f.140

Njeri mjaft i keq. Emocioni që të krijon kjo fjalë të ndjell neveri.

the thanes fly from me.= Më **dezertuan parësia**<sup>107</sup>

parësia nënkupton të gjithë njerëzit që janë dhe punojnë në oborrin mbretëror.

Have theirs, themselves = **gjindjen**, gjind<sup>108</sup>

Kuptimi është njeri, gjindja me kuptimin njerëzia, të gjithë njerëzit.

He brings great news. =Solli **lajmën**<sup>109</sup> me të madhe

Emërtime veshjesh, objektesh të vjetëruara, ose përshkrime të cilat sot kanë një tjetër kuptim.

Here's an English tailor come hither, for stealing out, a French hose: come in, tailor;

here you may =nga një palë **tirq** të ngushte prej frëngu.

Fjala Tirq<sup>110</sup> ka kuptimin, pantallona, është fjalë shumë e vjetëruar, nuk përdoret më sot.

I had thought to have let in, some of all **professions** that go the primrose way to the everlasting bonfire. =Kam pasur ndërmend të sjell brenda ca Yrneke<sup>111</sup> nga të gjitha zanatet prej atyre që baresin në udhën e shtruar me trëndafilë të zjarrit të përjetshëm.

Fjala e përdorur në këtë rast yrneke që do të thotë modele, ndërsa baresin do të thotë që ecin, shëtitin. Fjala yrnek është hasur edhe në vitet 70. Në Shqipërinë e mesme, në zonën e Korçës.

Or wear it on my sword, =ja vë në majën e një **ushte**<sup>112</sup>

Fjala ushtë është përdorur me kuptimin në majë të një shpate.

As this which now I draw.= Sa kjo këtu që zhvesh nga mylli<sup>113</sup>

Mylli është fjalë që nuk përdoret më dhe kuptimi leksikor është, nga këllefi, mbajtësja e kamës apo e shpatës.

O well done! I commend your pains; And every one shall share i' the gains;  
=Me paçi uratën, për naforën dhe Kungatën<sup>114</sup>

Të trija këto fjalë, uratën, naforën (një copë e vogël nga mesha) dhe kungatën kanë të bëjnë me bekimin, urimin dhe meshën. Kuptimi leksikor i të trija fjalëve lidhet me besimin fetar.

And now about the cauldron sing, = rreth altarit qerthulloni<sup>115</sup>

Në këtë rast fjala qerthulloni ka kuptimin këndonin rreth e rrotull altarit.

<sup>107</sup> Po aty f.142

<sup>108</sup> Po aty f.37

<sup>109</sup> Po atyf.37

<sup>110</sup> Po aty f.54

<sup>111</sup> Po aty.f.54

<sup>112</sup> Poaty f.118

<sup>113</sup> Po aty f.46

<sup>114</sup> Po aty F100

<sup>115</sup> Po aty f.100

By the pricking of my thumbs,= Veshi, motra më vengon<sup>116</sup>

Më pickojnë, më shpojnë gishtërinjtë dhe më buçasin veshët

Is this a dagger which I see before me =A është kamë kjo që shoh përpara?

and yet I see **thee** still. Art thou not, fatal vision, sensible =Apo s'je veç kam<sup>117</sup> e

mendjes, një krijes' e rreme

Makbethi ka vizione. Atij i del imazhi i armës me të cilin kreu aktin, vrasjen. Ai nuk shkëputet dot nga ky veprim.

Me shumë vuajnë nga zullmi<sup>118</sup> i atij që i zë vendin.

**Habere** është përdorur me sensin lajme.

Fjalë të vjetëruara në funksion të mbiemrit

Noli ka një përdorim shumë të pasur të leksikut vetiak të vjetëruar i cili funksionon si pjesë gramatikore mbiemërore:

you secret, black, and midnight hags! = lubira **faqemvrojtur**<sup>119</sup> të natës

the yellow leaf; =fletëfishkur<sup>120</sup>

I atribuohet njeriut dhe është përdorur nga Noli me nuancë përbuzëse.

I am too savage; = pashpirtmë<sup>121</sup> – i pashpirt, i eger.

More suffer and more sundry ways than ever, By him that shall succeed.

I see thee yet, in form as palpable =të shoh akoma aqë formëshkoqur<sup>122</sup>

Finger of birth-strangled babe Ditch-deliver'd by a drab, = **gisht prej foshnje**

Be lion-mettled = sythike<sup>123</sup>

Kjo fjalë leksikore bën që ky personazh me një përshkrim të tillë tërheq vëmendjen me gadishmërinë, trimërinë dhe mprehtësinë etj. Vizioni e këshillon Makbethin të jetë i tillë. Noli ka përdorur leksik kontekstual mjaft të spikatur.

birth-strangled babe Ditch-deliver'd by a drab,=

---

<sup>116</sup> Po aty f.100

<sup>117</sup> Po aty f. 46

<sup>118</sup> Po aty f.118

<sup>119</sup> Po aty f.101

<sup>120</sup> Po aty f 141

<sup>121</sup> Po aty f.114

<sup>122</sup> Po aty f.46

<sup>123</sup> Po aty f.104

**fytpërdredhur, kurvëlindur, hendekhedhur**<sup>124</sup> Në këto shembuj vihet re formimi i mbiemrave të përbërë emër plus pjesore **fy+** **-dredhur, hendek+-hedhur, -kurvë+lindur, faqe+-mvrojtur, fletë+-fishkur, formë+-shkoqur.**

her skinny lips: = zhubra<sup>125</sup>

Kjo do të thotë buzët tuaja të rrudhura. Ky përshkrim të jep një imazh përbuzës.

her chappy finger laying = duart e krasitura<sup>126</sup>

që do të thotë: të rraskapitura, të lidhura, të munduara.

We will speak further = e bisedojmë më shkoqur<sup>127</sup> = më qartë.

this strange intelligence? = këtë lajmë të çudiçime<sup>128</sup> ndërsa sot fjala është evoluar dhe kemi të përdorur fjalën të çuditshme, rrënja mbetet. Leksiku i përdorur nga Noli është mahnitës dhe tepër i arrirë.

Though all things foul would wear the brows **of grace**, = dhe **hir' i rremë si**

**dhe hir'**<sup>129</sup> i thjeshtë. Në këtë fjali kuptimi leksikor është sa i hijshëm por aq i pavërtetë, i gënjeshtërt.

me hir<sup>130</sup> të shpejtm'

del në pah përdorimi i apostrofit në fund të fjalës.

sundry blessings hang about his throne, = **te lartin**<sup>131</sup> **fron me hire** /

këtu të treja fjalët të lartin, fron dhe hire janë fjalë të vjetëruara,

So wither'd and so wild in their attire, = Ç'janë këto **të fishkura** dhe rrobëgjerra<sup>132</sup>, Në këtë varg **Noli** dëshiron të na japë emocionet që Makbethi përjeton me aktin që do të ndërremarrë. Atë e turbullojnë shumë vegime. Informacioni që transmetohet me shprehjet e mësipërme është dramatik. Bëhet aluzion për fundin tragjik që pret t'i ndodhë apo për gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodhen personazhet. Këtu kemi përdorimin e mbiemrave të substantivuar.

Art thou not, fatal vision, sensible = Pamje fatale<sup>133</sup>

Pamje vdekjeprurëse, të jep një ndjenjë të frikshme.

These evils thou repeat'st upon thyself, Have banish'd me from Scotland.

Veset që më shfaqe me syrgjynosë fare nga Skotlanda<sup>134</sup>

shpreh një ndjenjë dhembje, një brengë dhe jep nuancën e pesimizmit,

<sup>124</sup> Po aty f.100

<sup>125</sup> Po aty f.20

<sup>126</sup> Po aty f. 20

<sup>127</sup> Po aty f.35

<sup>128</sup> Po aty f.22

<sup>129</sup> Po aty f.117

<sup>130</sup> Po aty f.117

<sup>131</sup> Po aty. F124

<sup>132</sup> Po aty f. 20

<sup>133</sup> Po aty f.46

<sup>134</sup> Po aty f. 121



With Tarquin's ravishing strides, = si Tarkimi i hazdisur<sup>135</sup>

Kuptimi leksikor është i tërbuar.

Fjalë të vjetëruara në funksion të **foljes**

Është karakteristika e **Nolit** që të përdorë fjalë të vjetëruara në funksion të foljeve:

Till he **faced** the slave; = **e përbal**<sup>136</sup> të poshtrin,

E mund atë, i del zot.

cleave not to their mould = si ngjitet dot pas trupit =s'i ngjitet<sup>137</sup> dot pas trupit Në këtë fjali fjala ngjitet është përdorur me sensin nuk i rri pas trupit.

Shall he dwindle, peak and pine: = do ta **tret**<sup>138</sup>

**Kuptimi është** do ta bëj që të lëngojë dhe të dobësohet nga sëmundja.

There to meet with Macbeth.= hasim<sup>139</sup>

Sot përdoret fjala takojmë, hasim ka dalë nga përdorimi.

Implored your highness' pardon and set forth=

Lypi<sup>140</sup> ndjesë = I kërkoj të falur,

Në gjuhën e sotme letrare lyp përdoret kur i lutesh dikujt të të japë diçka falas. Fjala ka dalë nga përdorimi.

Commends the ingredients of our poison'd chalice=

Na zgjat në buzë vrerin që gatitëm<sup>141</sup> vetë

Vrerin është me kuptimin helmin.

Confronted him with self-comparisons,= sulmën ia dërmoi<sup>142</sup> = ia mposhti ,

Yet it shall be tempest-tost.= T'ia zhgërryej<sup>143</sup> do t'i a shkatërroj,

hand in hand, hand in hand, =dor për dore ziruni<sup>144</sup> = kapuni,

sot kjo fjalë ka një kuptim tjetër, grindemi. Në disa zona të rajonit të Korçës mund të haste rralle nga te moshuarit.

---

<sup>135</sup> Po aty f.47

<sup>136</sup> Po aty f.14

<sup>137</sup> Po aty f.26

<sup>138</sup> Po aty f.19

<sup>139</sup> Po aty f.12

<sup>140</sup> Po aty f. 28

<sup>141</sup> Po aty f.38

<sup>142</sup> Po aty f.16

<sup>143</sup> Po aty f.19

<sup>144</sup> Po aty f.19

I would applaud thee to the very echo, = do t' të **dorëtrokisja**<sup>145</sup> gjer në qiell.

sot është duartrokas. Noli ka përdorur numrin njëjës në vend të shumësit sepse veprimi është me të dyja duart.

**May read strange matters.** = **ku këndohen**<sup>146</sup> **gjëra të çudiçime**

këndohen me sensin lexohen.

Eshte për t'u theksuar se edhe në vitet 1980 fjala këndim ishte shumë e përdorëshme. Madje dhe në kurrikulën e shkollave thuhej se një nga lëndët ishte 'Këndimi' që sot është zëvendësuar me Lexim, në ciklin e parë pesëvjeçar, dhe në klasat më të larta Letersi.

We will proceed no further in this business: Më tej s' duhet ta ngasim<sup>147</sup> këtë punë

Nor time nor place Did then adhere, and yet you would make both = As koha as vendi nuk ujdin<sup>148</sup>

If you shall cleave to my consent, = në ma përkrahsh<sup>149</sup> mejtimin

craves composition = **Lyp**<sup>150</sup> **Paqen**

lyp vjetëruar. Nuk ka atë kuptim sot.

That tend on mortal thoughts, = **që na ndërseni sulmat vrasëse.**

Noli përdor për korbin ndërseni<sup>151</sup>, **Tjetër kuptim ka sot**, sepse nuk ndërsehet njeriu.

the cauldron sing, = rreth altarit **qerthulloni**<sup>152</sup>

është fjalë e vjetër dhe ka kuptimin: vijnë rrotull e këndojnë.

We have willing dames enough: there cannot be, That vulture in you, to devour so

many,

Gra zemërmira kemi sa të duash; s'besoj të jesh **kuçedr'** e **të mos ngijesh**<sup>153</sup>

Kuptimi i saj leksikor është të mos ngopesh, dmth si grabitqar të mos përlesh...

And that distill'd by magic sleights = pastaj **e ysht**, **e dishtilloj**<sup>154</sup>,

Kuptimi leksikor i ysht është e shtyj, e nxis.

**desired** your good advice, = **Lypja**<sup>155</sup> ca këshilla

<sup>145</sup> Po aty f.143

<sup>146</sup> Po aty f. 34

<sup>147</sup> Po aty f.39

<sup>148</sup> Po aty f.40

<sup>149</sup> Fan Noli, Makbethi I Shekspirit, Tiranë, Shtëpia Botuese N. Frashëri, f.45

<sup>150</sup> Po aty f.16

<sup>151</sup> Fan Noli, Makbethi I Shekspirit, Tiranë, Shtëpia Botuese N. Frashëri, 1943,f.33

<sup>152</sup> Po aty f.100

<sup>153</sup> Po aty. f. 119

<sup>154</sup> Po aty f.94

Në këtë kontekst lypja ka kuptimin kërkojë.

Disdaining fortune, with his **brandish'd** steel, = përbuzi fatin dhe me shpatën

**zgjeshur**<sup>156</sup>

Kuptimi është liroi, e kundërta e ngjeshi. Me shpatën gati për të goditur, në pozicionin jashtë këllëfit.

Till famine and the ague **eat them up**: = Gjer sa t'i **shtyp**<sup>157</sup> urija dhe murtaja

Deri sa t'i mundë urija dhe vdekja.

Good men's lives **expire** in their caps, = njerëzit e mir' e trimat **fishken**<sup>158</sup>

Ideja që mbart kjo fjali është: Trimat vdesin në përpjekje dhe luftë.

Your castle is surprised; = kështjellën ta **bastisën**<sup>159</sup>

Kështjellën ta kontrolluan me dhunë.

When was it she last walked? = kur ka **baritur**<sup>160</sup>

Kuptimi leksikor është **ka ecur**. Por sot sipas fjalorit ka kuptim "1. Që është bërë me bar. Shtroje e **Çati** (kasolle) e bartë. 2. Që s'ka shije, që ka humbur shijen: që s'ka kripë. Gjellë e bartë"<sup>161</sup>

Fjalë që shënojnë emra të ndryshëm të cilët paraqisin objekte ose nocione

but this **bird**=shpese<sup>162</sup> sot është përdorimi i fjalës 'ky shpend'.

a **stool**. = **karekllë**<sup>163</sup> sot është fjala **karrike**.

look into the **seeds** of time = farën<sup>164</sup> e së pritmes.

Këtu farën është përdorur për mundimin, përpjekjen

The earth hath **bubbles**, as the water has, = flluska<sup>165</sup> dheu

në këtë fjali flluska nënkupton copëza. Përdorimi i sotëm është me kuptim të ri. fluskat e sapoit, shkuma në ujë, etj.

**Stars**, hide your fires; = Yj<sup>166</sup>, u shuani.

Në këtë rast kemi përdorimin e yj jo yje.

<sup>155</sup> Po aty f.69

<sup>156</sup> Po aty f.14

<sup>157</sup> Po aty f.146

<sup>158</sup> Po aty f.125

<sup>159</sup> Po aty f.128

<sup>160</sup> Po aty f.131

<sup>161</sup> Fjalor I Shqipëse se Sotme. Botimet Toena, Tirane, 2002.f.91

<sup>162</sup> Po aty f.36

<sup>163</sup> Po aty f.88

<sup>164</sup> Po aty f.21

<sup>165</sup> Po aty f.22

<sup>166</sup> Po aty f.30

no jutty, frieze, Buttress, nor coign of vantage, but this bird= S'ka asgjëkund

një çip<sup>167</sup> ku të mos ketë va, fole e djep për zogjt

Mendojmë se një çip është përdorur në vend të nje 'cep' i cili përdoret sot në të folurën informale me kuptimin një vend.

He brings great **news**= Solli lajmën më të madhe = lajmën<sup>168</sup>

përdorimi i mbaresës -en në rasë kallxore, sot është lajmin,

I' the shipman's card.=kart,<sup>169</sup>

këtu është me kuptimin hartë, ndërsa sot ka të tjera kuptime, si letër.

what **purgative drug**, = **recin' e purgatif**<sup>170</sup>

purgative është me sensin ilaç. ////////////// Nuk përdoret sot.

Than summer-seeming lust, = se sa **azganësia**<sup>171</sup> pranverore

for an **earnest** of a greater **honour**,=dhe si **kapar** prej nderesh më të larta,

dhe si **kapar**<sup>172</sup> shpreh një nocion i cili do të thotë si kompesim. Në këtë rast për të kompesuar këto nderë.

Sot kjo fjalë ka kuptim të lesh një shumë të caktuar parash për marrjen e një objekti, apo për zotimet, dhe premtimet.

Eshtë karakteristike e Nolit të përdorë fjalë të vjetëruara në formë të pashquar.

Fjalë të vjetëruara në funksion të **ndajfoljes**

Shumë fjalë të përdorura nga **Noli** janë historizma ndajfoljore:

To make their audit at your highness' pleasure, Still to return your own. = do

t'jua kthejmë me **hesap**,<sup>173</sup> të plotë,

Këtu tregon mënyrën se si do t'ua kthejë veprimin

then done double=dhe pasandaj te dyfishuara = pasandaj<sup>174</sup>

përdoret si ndajfolje në të folurën informale sepse sot përdoret ndajfolja pastaj.

I'll be myself the harbinger and make joyful = Na falni plotërisht<sup>175</sup>= plotësisht,

<sup>167</sup> Po aty.f.36

<sup>168</sup> Po aty f.33

<sup>169</sup> Po aty f.21

<sup>170</sup> Po aty f.143

<sup>171</sup> Po aty. F120

<sup>172</sup> Po aty f.24

<sup>173</sup> Po aty f.37

<sup>174</sup> Po aty f.36

<sup>175</sup> Po aty f.30

So humbly take my leave.= Lyp lejen pra përunjërisht = përunjërisht<sup>176</sup> vemë re se kemi prapashtesës - risht në të dy këto shembujt e fundit.

Fjalë të vjetëruara të përdorura me apostrof në fund të fjalës

**great bond = senetn'**<sup>177</sup> e madh që po ma verdh fytyrën =senetn' e vjetër

dëftesë me të cilën vërtetohet marrja e një huaje me kamatë ose shitja dhe blerja e një malli<sup>178</sup>

noise=Shamat'<sup>179</sup> e luftës = Zhurma e luftës, luftimet,

that but this blow, Might be the be-all and the end-all here,=

Një her' e mir' hesapn'<sup>180</sup>e saj ta mbyllte.

treasons capital,= po e përmbysi tradhësi' e lartë=.tradhësi'<sup>181</sup> e lartë,

sot kemi përdorimin e prapashtesës -ti në vend të - si. Ndaj sot na paraqitet fjala tradhëti.

With most admired disorder. = me **ca përçatj'**<sup>182</sup> **Historizma**

place reserved, sir.= **karekll'**<sup>183</sup> karekll'

tooth of wolf, = **lusp' lubije'**<sup>184</sup>

stomak lubije me sensin i pangopur.

Si përfundim fjalët e vjetra me kuptim të ri tentojnë të mos jenë kulturore dhe teknike. Kështu ato mund të përdoren me kuptimin që ka pas ekzistuar, ose thjesht me një kuptim përshkrues. Por është detyra e përdoruesit apo e shkrimtarit që fjalët e përdorura bisedimore, terminologjitë, përshkruese t'i përdorin ato me kuptim figurativ.

Shprehjet bisedimore me kuptime të reja mund të mos jenë kulturore nëse i referohen koncepteve ose objekteve që ekzistojnë. Nëse koncepti nuk egziston atëherë përdoruesi duhet të përdorin një ekuivalent përshkrues, ose të krijojë një shprehje të re.

### Literatura Bazë

1. Fan Noli, 'Makbethi', Tiranë 1943.
2. Shakespeare, (Great Books Of The Western World), volume 2, 1952.
3. A.Xhuvani –E. Çabej. Prapashtesat e gjuhës shqipe,1962

<sup>176</sup> Po aty f.30

<sup>177</sup> Po aty f.79

<sup>178</sup> Fjalor i shqipes se sotme, Botimet Toena, Tirane ,2002, f.1172

<sup>179</sup> Po aty f.12

<sup>180</sup> Po aty f.38

<sup>181</sup> Po aty f.25

<sup>182</sup> Po aty f.91

<sup>183</sup> Po aty f.86

<sup>184</sup> Po aty f. 99

## Literatura ndihmëse

1. A.Xhuvani, Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqip, Buletini i institutit të Shkencës,III,2194
2. A.Kostallari, Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese, “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve”, 1, 1972
3. A.Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe 1,1972
4. A.Kostallari, Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes, “Studime mbi leksikun”,II,1972
5. A.Kostallari-XH. Lloshi, Mbi gjuhën e shtypit të sotëm Norma Letrare & Kultura 1991
6. A.Dhrama, Fan Stilian Noli Tribun i fjalës shqipe “Gjuha Jonë”, 1987,2.
7. G.Hadaj Shembuj analize Tekstit “Revista Pedagogjike”, 1984,3.
8. J.Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, 1984, 2006
9. M.Celiku, Disa togje foljore në gjuhën e sotme, Buletini I USHT, 1963.
10. Xh.Lloshi “Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe”, 1987
11. Hyrje në gjuhësi (tekst) 1976
12. <http://www.shakespeare-online.com/sources/macbethsources.html> Internet.
13. N. Varfi, Leksikologjia e gjuhës frënge, Tiranë, 2006
14. Çabej, Studime gjuhësore, III, Prishtinë, 1977